

Ac.nr.473/14

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS , në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Qerim Ademaj-kryetar i kolegjit, Fejzullah Rexhepi dhe Ramë Hyseni-anëtarë të kolegjit, në çështjen juridiko kontestimore të paditësit B.M. nga fshati ..., Komuna e Vushtrrisë, të cilin e përfaqëson përfaqësuesi i autorizuari N.P. avokat në Prishtinë, kundër të paditurve Republika e Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Policia e Kosovës, të cilat i përfaqëson përfaqësuesja juridike e Ministrisë së Drejtësisë së Kosovë N.K. sipas autorizimit, me bazë anulimin e vendimit të Komisionit Disiplinor dhe kthim në punë, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarit të paditësit, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.723/13 i datës 04.10.2013, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 12.10.2016, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e të autorizuarit të paditësit B.M. nga fshati ..., Komuna e Vushtrrisë, dhe VËRTETOHET Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.723/13 i datës 04.10.2013.

## A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, si gjykatë e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar, C.nr.723/13 i datës 04.10.2013, me pikën I (një) të dispozitivit e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit B.M. nga fshati ..., Komuna e Vushtrrisë, me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi i Komisionit të Brendshëm Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme, nr.28/KBD/12 i datës 29.01.2013 dhe vendimi i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, Nr.01/285/213 i datës 28.02.2013, me të cilët është shpallur fajtor dhe i është shqiptuar masa disiplinore “ndërprerje e marrëdhënies së punës”, si dhe te detyrohen të paditurat që paditësin ta kthejnë në punë në Policinë e Kosovës, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm. Ndërsa me pikën II (dy) të dispozitivit te të njëjtit aktgjykim është vendosur që secila palë ti bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë i autorizuari i paditësit, duke e goditur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim bërë Gjykatës së Apelit që të aprovohet si e bazuar

ankesa e ushtruar, aktgjykimi i goditur të priset dhe lënda ti kthehet të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe vendosje ose aktgjykimi i atakuar të ndryshohet ashtu që kërkesëpadia e paditësit të aprovohet në tërësi si e bazuar.

E autorizuar e të paditurave nuk ka dhënë përgjigje në ankesën e ushtruar nga i autorizuari i paditësit.

Gjykata e Apelit e Kosovës i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore në kuptim të nenit 194 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), ku pas kësaj ka gjetur se:

-Ankesa e të autorizuarit të paditësit është e pathemeltë

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi përmes të autorizuarit të tij me datën 19.03.2013 në gjykatën e shkallës së parë, kundër të paditurave ka paraqitur padi për kthim në vendin e punës dhe kompensimin e pagave, të cilën për se fundi herë e ka precizuar në seancën përgatitore të mbajtur më datë 04.10.2013, më kërkesën që të anulohen si të kundërligjshme vendimi i Komisionit Disiplinor të Brendshëm, nr.28/KBD/12 i datës 29.01.2013 dhe vendimi i DPPK-01/285/2013 i datës 28.02.2013, si dhe të detyrohen të paditurat që paditësin ta kthejnë në vendin e tij të punës në Policinë e Kosovës në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm. Te paditurat po ashtu të obligohen në pagesën e shpenzimeve të procedurës kontestimore.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë dhe kërkesës së saj, ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor në të cilën sipas propozimit të të autorizuarve të ndergjyqjesve ka nxjerrë dhe administruar provat nga shkresat e lëndës, ku me analizimin dhe vlerësimin e tyre secilën veç e veç e në lidhshmëri njëra me tjetrën, ka vërtetuar plotësisht dhe në mënyrë të drejtë gjendjen faktike, në bazë të së cilës gjendje faktike duke zbatuar drejtë edhe dispozitat ligjore nga e drejta materiale, ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar C.nr.723/13 i datës 04.10.2013, me të cilin e refuzon në tërësi kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të të njëjtit, ashtu siç Gjykata e Apelit e ka përshkruar më lartë në pasuesin e parë të arsytimit të këtij aktgjykimi.

Lidhur më mënyrën e vendosjes sipas aktgjykimin të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ka arsytuar se nga shkresat e lëndës, asaj gjykate i ka rezultuar se Komisioni Disiplinor i të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme, pas mbajtjes se seancës dëgjimore me paditësin, ka gjetur se paditësi është fajtor për shkak se me datë 06.01.2012 rreth orës 19:50 gjatë kryerjes se detyrës zyrtare në pikën statike të sigurimit në objektin e hetimeve rajonale në Prishtinë, nga qytetarja V.L. ka pranuar një portofol më shumë të parave prej 522 Dollar Amerikan, 50 euro dhe 5 cent si dhe një kartelë beauty club, të cilat ajo i kishte gjetur në një veturë taksit, ku me pranimin e tyre paditësi qytetares V.L. nuk i kishte lëshuar ndonjë vërtetim për pranim-dorëzim të sendeve të pranuar, kishte grisur fletoren e shënimeve ku kishte vendosur shënimet e kësaj

qytetareje, shumën e të hollave me portofol i kishte futur ne xhepin e tij dhe nuk kishte raportuar tek mbikëqyrësi i tij ashtu siç parashihet me parimet dhe procedurat e policisë. Komisioni i të paditurës po ashtu kishte konstatuar se paditësi më datë 14.10.2011 rreth orës 15:40 derisa ishte jashtë detyrës zyrtare, kishte arritur marrëveshje me M.S.-taksi i motokultivatorit dhe I.A. punëtor krahu, për të bartur 5 gypa te betonit nga fshati Frashër Komuna e Mitrovicës për në fshatin ... Komuna e Vushtrrisë ku banon paditësi, me ç'rast gjatë bartjes së këtyre gypave i ndalon një patrollë e Policisë së Kosovës, të cilët i urdhëron qe gypat te kthehen ne vendin ku ishin marrë pasi qe të njëjtit ishin pronë e Komunës se Mitrovicës, te dedikuar për instalim ne fshatin Frashër, ku ndaj paditësit lidhur më këtë është iniciuar procedurë penale me dyshim se ka kryer vepër penale të vjedhjes.

Si pasojë e këtyre veprimeve të ndërmarra nga paditësi, Komisioni Disiplinor i të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme, kishte gjetur se paditësi ka bërë shkelje disiplinore nga kreu II, neni 5 pika 3 dhe 12 të Udhëzimit Administrativ të MBP nr. 15/2008 për llojet e shkeljeve të lehta dhe të rënda ne Policinë e Kosovës, e lidhur me nenin 46 pika a të Ligjit nr. 03/L-035 për Policinë, me çka me vendimin nr.28/KBD/12 i datës 29.01.2013, i ka shqiptuar masën disiplinore „ ndërprerje e marrëdhënies se punës “ i cili vendim sipas ankesës së paditësit ishte vërtetuar edhe nga organi i shkallës së dytë te të paditurës me vendimin nr. DPPK-01/285/2013 i datës 28.02.2013.

Gjykata e shkallës së parë ka shtuar se vendimet e Komisionit të Brendshëm Disiplinor nr.28KBD/12, i datës 23.01.2013 dhe vendimi tjetër i nxjerrë nga Drejtori i Policisë së Kosovës nr.01/285/2013, i datës 28.02.2013, janë vendime të drejta dhe të ligjshme ngase e paditura ka respektuar të gjitha procedurat e parapara ligjore dhe kanë vendosur në mënyrë të drejtë kur ka gjetur se paditësi ka bërë shkelje të cilat bien ndesh me Udhëzimin Administrativ nr.15/2008, kreu II, neni 5, paragrafi 3 dhe paragrafi 12 e lidhur me nenin 46 të Ligjit për Policinë e Kosovës, pasi që paditësi gjatë kryerjes së detyrës zyrtare kishte ndërmarrë veprime të cilat haptazi bien në kundërshtim me rregullat dhe standardet e sjelljes së SHPK-së, e posaçërisht duke pasur parasysht pozitën specifike të personit zyrtar. Gjate shqyrtimit kryesor paditësi nuk ka paraqitur ndonjë provë të re me të cilën do të vërtetonin në procedurë gjyqësore faktet të cilat do të ishin në kundërshtim me faktet e provuara nga Komisioni i Brendshëm Disiplinor i të te paditurës, sikurse paditësi nuk ka prezantuar ndonjë provë të re me të cilën do të vërtetonin faktin se masa disiplinore e shqiptuar nuk është në proporcion me shkeljet e bëra sipas parimeve dhe akteve të te paditurës. Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata e shkallës së parë ka vepruar konform dispozitës së nenit 450 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës lidhur më mënyrën e vendosjes sipas aktgjykimit të ankimuar, është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g),( j), (k) dhe (m) të LPK-së dhe drejtë është zbatuar e drejta materiale, për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së. Aktgjykimi i ankimuar rezulton te

mos jetë i përfshirë as me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore sipas pretendimeve ankimore të bëra përmes ankesës së ushtruar nga i autorizuari i paditësit.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, duke i provuar kështu të gjitha faktet vendimtare të çështjes me çka ka krijuar një figurë të qartë të gjendjes faktike nga e cila pastaj në përputhje me normat e të drejtës materiale ka nxjerrë përfundimin për themelësinë e kërkesëpadisë.

Nga shkresat e lëndës konstatohet së një numër relativisht i madh i fakteve të çështjes kanë qenë jokontestuese, por edhe janë provuar me provat e administruara në shqyrtimin kryesor. Sipas Gjykatës se Apelit pothuajse të gjitha pretendimet ankimore të të autorizuarit të paditësit më tepër i referohen vlerësimit që ka bërë gjykata e shkallës së parë përkitazi me ligjshmërinë e vendimeve të marra nga e paditura në procedurën disiplinore sipas gjendjes faktike të konstatuar në shqyrtimin kryesor.

Në këtë kontekst gjykata e shkallës e parë me provat e administruara ka sqaruar faktet vendimtare të çështjes në mënyrë të kujdesshme duke dhënë vlerësime adekuate për fuqinë provuese të secilës provë dhe rrjedhimisht të secilit fakt për mënyrën se si gjykata i ka kualifikuar në raport me normën materialo-juridike. Gjykata e Apelit nuk i ka pranuar pretendimet ankimore të palës paditëse, pasi që këto pretendime kanë të bëjnë me vlerësimet e të paditurës, përkatësisht organeve të të paditurës për vlerësimin që ka bërë e paditura përkitazi me veprimet e paditësit, për të cilat paditësit i është shqiptuar masa disiplinore ndërprerja e marrëdhënie se punës, ligjshmërinë e të cilave sipas kësaj gjykate, drejtë dhe në mënyrë të plotë e ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë. E drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë nga gjykata e shkallës e parë dhe në këtë pikë Gjykata e Apelit e pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm përfundimin e gjykatës së shkallës së parë duke shtuar se procedura disiplinore tek organi kompetentë i të paditurës është zhvilluar në harmoni të plotë me dispozitat ligjore të aplikueshme në kohën kur është konstatuar se është kryer shkelja disiplinore nga ana e paditësit.

Pretendimi i palës ankuese se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) të LPK-së, me arsyetimin se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban arsye për faktet vendimtare dhe është në kundërshtim me provat e administruara, është pretendim i pathemeltë dhe i paqëndrueshëm, sepse sipas Gjykatës se Apelit me analizimin dhe vlerësimin e shkresave lëndore dhe aktgjykimit të ankimuar, rezulton se gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e ankimuar ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat kanë pasur ndikim rreth mënyrës se vendosjes sipas te njëjtit aktgjykim, ku faktet e vërtetuara nga gjykata e shkallës së parë kanë mbështetje të plotë në provat shkresore të cilat i ka administruar gjatë shqyrtimit kryesor.

Pretendimi i palës ankuese se gjykata e shkallës së parë me rastin e nxjerrjes së aktgjykimit të ankimuar, ju ka falur besimin vetëm pretendimeve të pa argumentuara të të paditurës të dhëna në vendimet më të cilat paditësit i ishte shqiptuar masa e ndërprerjes së marrëdhënies se punës, duke parafrazuar gjetjet e të paditurës dhe duke mos dhënë arsye vendimtare lidhur me ligjshmërinë e vendimit të të paditurës për shqiptimin e masës disiplinore paditësit, për ndërprerjen e marrëdhënies se punës, edhe pse paditësi gjatë procedurës kontestimore të udhëhequr ka deponuar prova më të cilat ka vërtetuar faktin se nuk ka shkelur asnjë dispozitë ligjore pozitive, për rastin në bazë të së cilit e paditura ja ka shqiptuar masën disiplinore të ndërprerjes se marrëdhënies se punës, për Gjykatën e Apelit është pretendim i pathemeltë për arsyet si në vijim.

Parimisht në të gjitha rastet duke përfshirë edhe rastin konkret kur një organ disiplinor i cili ekziston pranë organit punëdhënës, inicon dhe udhëheq procedurën ndaj një punëtori apo punëmarrësi për shkelje të detyrave të punës, çdoherë ka për detyrim që fillimisht të mbledh prova më të cilat do të vërtetohen faktet rreth shkeljes së mundshme të detyrave të punës nga punëtori, pastaj nëse me provat e mbledhura vërtetohet se ka fakte të mjaftueshme për shkelje të detyrave të punës, duhet të konstatoj se shkeljet e bëra të detyrave të punës a bëjnë pjesë në grupin e shkeljeve të lehta apo të rënda disiplinore të cilat parashihen me ligj apo me aktet e brendshme të organit punëdhënës, që pastaj në fund m' 'varësisht prej shkeljes së bërë të mund të shqiptohet masa përkatëse disiplinore e cila parashihet për shkeljen e bërë e cila çdoherë duhet të jetë në proporcion apo baraspeshë me llojin e shkeljes së konstatuar.

Në çështjen lëndore rezultoi se gjatë shqyrtimit kryesor me provat e administruara nga gjykata e shkallës së parë, janë bërë jokontestuese faktet se paditësi me datën 06.01.2012 rreth orës 19:50 gjatë kryerjes së detyrës zyrtare në pikën statike të sigurimit në objektin e hetimeve rajonale në Prishtinë, nga qytetarja V.L. ka pranuar një portofol më shumë të parave prej 522 Dollar Amerikan, 50 euro dhe 5 cent si dhe një kartelë beauty club. Për pranimin e këtyre gjerave paditësi qytetares V.L. nuk i kishte lëshuar asnjë vërtetim për pranimin-dorëzimin e këtyre gjëseneve dhe nuk kishte lajmëruar as eprorin e tij dhe as kolegun e tij më të cilin atë natë ishin së bashku duke punuar në vendin e tyre të punës. Gjësendet e pranuar paditësi atë natë rreth orës 21:00 jua kishte dorëzuar eprorit kompetentë të të paditurës A.A, vetëm pasi që ky së bashku me qytetaren V.L. dhe gjyshin e saj M.L. kishin shkuar në vendin e tij të punës, për ta identifikuar rreth pranimin të gjëseneve të dorëzuara nga V.L., ku me rastin e dorëzimit të tyre ishte konstatuar se paditësi gjësendet e pranuar i kishte pasur të futur në xhepin e tij, ndërsa fletën e shënimeve më të cilën kishte marrë të dhënat personale të qytetares V.L. më rastin e pranim-dorëzimit të gjëseneve e kishte shqyer.

E paditura mbi bazën e këtyre fakteve, duke zhvilluar dhe udhëhequr procedurën disiplinore në mënyrë të rregullt, paditësin e gjen fajtor për shkelje disiplinore nga kreu i II-të, neni 5 pika 3 dhe 12 të Udhëzimit Administrativ nr. 15/2008-MBP e lidhur me nenin 46 pika a) të Ligjit për Policinë, ku edhe i shqipton masën disiplinore të ndërprerjes së marrëdhënies së punës, e cila masë disiplinore sipas ankesës së ushtruar nga paditësi mbetet në fuqi edhe nga organi i shkallës së dytë pranë të paditurës.

Me dispozitën e nenit 5 pika 2 dhe 12 të Udhëzimit Administrativ nr. 15/2008-MBP për llojet e shkeljeve të rënda dhe të lehta disiplinore në Policinë e Kosovës shprehimisht parashihet se *Zyrtari Policor dhe apo stafi civil i Policisë së Kosovës është fajtor për sjellje të rëndë diskredituese nëse nuk jep përgjegjësi të duhur apo nuk ruan si duhet, ose nuk bënë kthimin e menjëhershëm të parave ose pronës që është pranuar nga ana e tij apo saj gjatë kryerjes së detyrës zyrtare dhe sillet në mënyrë të tillë duke i vënë hije të keqe apo të turpshme Policisë së Kosovës gjatë kryerjes së detyrës apo jashtë saj ”*

Po që se i referohemi dispozitës ligjore të nenit 5 pika 2 dhe 12 të Udhëzimit Administrativ nr. 15/2008-MBP për llojet e shkeljeve të rënda dhe të lehta disiplinore në Policinë e Kosovës, qartë vijmë në përfundim se e paditura me rastin e shqiptimit të masës disiplinore paditësit, drejtë ju ka referuar dhe ka zbatuar këtë dispozitë ligjore, pasi që edhe sipas mendimit të Gjykatës së Apelit, veprimet e ndërmarra nga i padituri më datë 06.01.2012 paraqesin sjellje të rëndë diskredituese, meqë në kuptim të pikës 3 të nenit 5 të këtij udhëzimi administrativ rezultoi se paditësi ka pasur detyrim ligjor që gjësendet e pranuar nga qytetarja V.L., menjëherë pas pranimin të dorëzoj tek personat përgjegjës të të paditurës, gjë e cila nuk është ndërmarrë nga

paditësi. Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi gjësendet e pranuar ja ketë dorëzuar eprorit të te paditurës A.A të njëjtën natë rreth orës 21:00, vetëm pasi që ky epror kishte shkuar ne vendin e punës ku qëndronte paditësi, për ta bërë identifikimin e zyrtarit policor i cili kishte pranuar të hollat nga qytetarja V.L., pasi që e njëjta e kishte lajmëruar rastin tek e paditura.

Çdo arsyetim i paditësit bërë tek organi kompetent i të paditurës ne procedurën disiplinore te udhëhequr, rreth pamundësisë se paditësit që me kohë ti dorëzon te hollat tek personat përgjegjës te të paditurës , qoftë për shkaqe objektive dhe subjektive të cilat i ka potencuar në atë procedurë, edhe për Gjykatën e Apelit rezulton te jenë arsyetime të pabaza, pasi që sipas kësaj gjykate organi disiplinor i të paditurës me provat e mbledha qartë dhe drejtë ka vërtetuar se mos raportimi më kohë i paditësit tek eprori i tij apo kolegu i tij për pranim te të hollave nga qytetarja V.L., mos evidentimi i gjësendeve të pranuar ne fletoren ditore zyrtare te shënimeve, fleta e shqyer e të dhënave personale të marra nga dorëzuesja e gjësendeve dhe futja e saj se bashku me kuletën e pranuar ne xhepin e tij, paraqesin shkelje të rëndë diskredituese nga neni 5 pika 2 dhe 12 të Udhëzimit Administrativ nr. 15/2008-MBP për llojet e shkeljeve te rënda dhe të lehta disiplinore në Policinë e Kosovës.

Me dispozitën e nenit 46 pika a) të Ligjit nr. 03/L-035 për Policinë, i cili ka qenë ne fuqi ne kohën kur paditësi rezulton te ketë kryer shkeljen disiplinore nga neni 5 pika 2 dhe 12 të Udhëzimit Administrativ nr. 15/2008-MBP për llojet e shkeljeve te rënda dhe të lehta disiplinore në Policinë e Kosovës, shprehimisht parashihet „ *Zyrtarët policorë dhe stafi civil bëjnë shkelje të rëndë disiplinore nëse ai/ajo kryen, tenton të kryejë, ndihmon ose nxit tjetrin ta kryejë njërën nga veprimet e mëposhtme: a) sjellja e rëndë diskredituese* ”.

Me dispozitën e nenit 48 paragrafi 1 pika a) të Ligjit nr. 03/L-035 për Policinë shprehimisht parashihet „ *Masat për shkeljet e rënda disiplinore Zyrtari policor ose stafi civil i Policisë i cili ka kryer shkelje të rëndë disiplinore i nënshtrohet njërës nga masat disiplinore: a) ndërprerjes së marrëdhënies së punës* ”, me çka ne kuptim të kësaj dispozite ligjore rezulton se masa disiplinore për ndërprerjen e marrëdhënies se punës paditësit e cila i është shqiptuar nga e paditura, është në proporcion apo baraspeshë me llojin e shkeljes se konstatuar dhe ka mbështetje të plotë më dispozitat ligjore të këtij ligji, i cili ka qenë ne fuqi ne kohën kur paditësi ka kryer shkeljen disiplinore nga neni 5 pika 2 dhe 12 të Udhëzimit Administrativ nr. 15/2008-MBP për llojet e shkeljeve te rënda dhe të lehta disiplinore në Policinë e Kosovës.

Masa disiplinore e ndërprerjes se marrëdhënies se punës paditësit, gjen mbështetje edhe ne dispozitën e nenit 70 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 pika 1.4.2 dhe paragrafi 4 të Ligjit nr. 03/L-212 i Punës, më të cilat dispozita shprehimisht parashihet „ *Punëdhënësi mund t’ia ndërpres kontratën e punës të punësuarit në periudhën kohore të paralajmërimit në rastet e rënda të sjelljes se keqe te punonjësit. Marrëveshjet kolektive ose Aktet e Brendshme të Punëdhënësit mund ti specifikojnë llojet e keq sjelljeve ose te shkeljeve te detyrimeve të cilat bëjnë që i punësuarit ti nënshtrohet ndërprerjes se kontratës se punës pa periudhë paralajmërimi, qoftë pas një rasti të vetëm dhe qoftë pas shkeljeve te përsëritura* ”

Pretendimi tjetër ankimor, se gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes sipas aktgjykimit të ankimuar ka marrë për bazë dhe ju ka referuar edhe rastit të ndodhur më datë 14.10.2011 edhe pse ky rast nuk ka shërbyer si bazë për shpalljen fajtor të paditësit ne procedurën disiplinore, për Gjykatën e Apelit është pretendim i pathemeltë dhe jo relevant për çështjen ne fjalë, për faktin se përkundër asaj që gjykata e shkallës së parë ne arsyetim të aktgjykimit të ankimuar sipërfaqësisht ju ka referuar edhe rastit të ndodhur më datë 14.10.2011, kjo është pa ndonjë ndikim ne

ligjshmërinë e aktgjykimit të ankimuar, pasi që gjykata e shkallës së parë më rastin e vendosjes qartë rezulton se ka shqyrtuar ligjshmërinë e vendimeve të organit disiplinor të të paditurës lidhur më masën disiplinore të shqiptuar paditësit për rastin e ndodhur më datë 06.01.2012, e jo për rastin e ndodhur më datë 14.10.2011, pasi që për këtë rast e paditura nuk ka udhëhequr ndonjë procedurë disiplinore ndaj paditësit dhe rastin si rast e ka dërguar ne procedurë te rregullt pranë organeve kompetente, më qëllim që te mund të argumentohet akuza e ngritur ndaj paditësit edhe për këtë rast të ndodhur.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes ka pasur parasysh edhe pretendimet tjera të palës ankuese, që i referohen ligjit mbi Policinë dhe Udhëzimit Administrativ të të paditurës nr. 15/2008 për llojet e shkeljeve të rënda dhe të lehta disiplinore në Policinë e Kosovës, që kanë qenë ne fuqi në kohën kur është shqiptuar masa disiplinore ndaj paditësit, si dhe parashkrimin të ndjekjes për shkeljen disiplinore, ku më vlerësimin e tyre kjo gjykatë ka gjetur se janë të pathemelta për faktin se kjo gjykatë gjen se ne kohën kur paditësi ka kryer shkeljen disiplinore ne fuqi ka qenë Ligji nr. 03/L-035 për Policinë dhe ka qenë ne zbatim edhe Udhëzimi Administrativ i të paditurës nr. 15/2008 për llojet e shkeljeve të lehta dhe të rënda ne Policinë e Kosovës, me çka organi disiplinor i të paditurës me rastin e shqiptimit të masës disiplinore paditësit nuk ka mundur të zbaton Ligji Nr. 04/ L-076 për Policinë, i cili ka hyrë ne fuqi pasi që paditësi ka kryer shkeljen disiplinore për të cilën nga e paditura është shpallur fajtor, meçe ligjet nuk mund te ketë veprim prapaveprues (retroaktiv).

Sa i përket pretendimit ankimor të palës ankuese për parashkrim të ndjekjes për shkelje disiplinore ky pretendim sipas kësaj gjykate po ashtu del te jetë i pa bazuar, për faktin se nga shkresat e lëndës ka rezultuar se e paditura pas rastit të ndodhur më datë 06.01.2012, menjëherë, ka filluar me mbledhje të provave për vërtetim të fakteve rreth shkeljes disiplinore bërë nga paditësi lidhur më këtë rast të ndodhur, ku pas mbledhjes se tyre ka vërtetuar se paditësi është fajtor për rastin e ndodhur më datë 06.01.2012, dhe me vendimin e saj të datës 23.10.2013 edhe i ka shqiptuar masën përkatëse disiplinore të ndërprerjes se marrëdhënies se punës, me çka ne rastin konkret nuk ka mundur të gjej zbatim instituti i parashkrimin të ndjekjes disiplinore, i cili edhe ashtu nuk parashihet me asnjë akt te brendshëm te nxjerrë nga e paditura.

Prandaj nga të lartcekurat, e në mbështetje të dispozitës ligjore të nenit 195.1 pika d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

Ac.nr.473/14, me datë 12.10.2016

Kryetari i kolegjit-gjyqtari,  
Qerim Ademaj, d.v.